




## FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT

ALBANIAN FOOTBALL ASSOCIATION

Nr. 1205 Prot

Tiranë, më 26.06.2025

**Drejtuar:** Z. Genti Gazheli  
Drejtor i Përgjithshëm i Doganave



**Lënda:** Falënderim për bashkëpunimin

I nderuar Z. Gazheli,

Federata Shqiptare e Futbollit dëshiron t'ju shprehë mirënjohjen më të sinqertë për punën profesionale, bashkëpunimin dhe angazhimin tuaj të palodhur në evidentimin dhe ndalimin e rasteve të kontrabandës së produkteve sportive që mbajnë markat dhe logot e mbrojtura të FSHF-së.

Ky fenomen përbën jo vetëm një shkelje të drejtave të pronësisë intelektuale, por edhe një dëm të drejtpërdrejtë ndaj zhvillimit të sportit, pasi të ardhurat nga shitja e produkteve zyrtare janë ndër burimet kryesore që mbështesin aktivitetet sportive, veçanërisht ato të lidhura me rininë, zhvillimin e futbollit bazë dhe organizimin e kompeticioneve kombëtare.

FSHF mbetet e vendosur për të vazhduar punën në bashkëpunim të ngushtë me institucionet shtetërore për të luftuar çdo formë të këtij fenomeni, duke mbrojtur njëkohësisht interesat e ligjshme të sportit dhe të komunitetit që e mbështet atë.

Ju falënderojmë edhe një herë për mbështetjen tuaj dhe jemi të bindur se bashkëpunimi ynë do të forcohet më tej në të ardhmen.

Me Konsideratë,

